



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:2	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	29.06.2022 Ora: 16:00
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none">1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;3. Tahir ef. Bekaj, Bashkësia Islame;4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,5. Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse,6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar;7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;8. Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak;9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;14. Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;16. Enver Boletini, KLSP-Gurakoc;17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;18. Blendinela Shatri, EVSB;19. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;20. Enisa Ćorović, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;21. Blendor Isufaj, KVRL;22. Zeqir Mehmetaj, Radio“Fontana“;23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS; dhe24. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.
	Mungojnë: Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike;

	<p>Enver Boletini, KLSP-Gurakoc; Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë; Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;</p> <p>Pjesëmarrës tjerë: Arben Kabashi, Drejtor i Drejtoratit Sherbime Publike, Rasim Mahmutovic, ZLK Ardon Arifaj, Komuna Istog; Mehmed Qeman, përkthyes; Gjyldane Ahmeti, OSCE Bahrije Muqa, OSCE;</p>
--	---

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga Mbledhja e kaluar
3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK
4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.)
5. Qent endacak, sulmi ndaj fëmijve dhe personave të ndjeshëm
6. Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore
7. Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuarepengohet lëvizja e lirë e qytetarvenë veçanti personat me nevoja të veçanta
8. Monitorimi i funksionimit të këshillave në të gjitha Shkollat
9. Problemet që ndikojn në siguri, në zonat urbane të minoriteteve
10. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Përhëndet të gjithë të pranishmit, anëtarët e KKSB-së. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve dhe pyet a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës.

Pasi që diskutime nuk pat:

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga Mbledhja e kaluar

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës –Pyeti antarët e KKSB-së a ka dikush vërejtje në procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Me qe nuk pati vërejtje, Nënkyetari pyeti kush është për miratimin e procesverbalit. Gjithë antarët e KKSB-së votuan për miratimin e procesverbalit.

3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policis.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog -Gjëndja në zonën e përgjegjesisë së stacionit Istog është e qetë, stabile dhe e qendrueshme. Deri në periudhën që raportoj në stacionin e Policis kemi pas të paraqitura gjithsejt 331 raste. Ne me datën 01.07 e hartojm raportin gjashtë mujor dhe nstatistikat ma detale do ti paraqes në mbledhjen e radhes. Do kishte qen ma mirë që mbledhja të ftohet me datën 1 apo 2 dhe do ta kisha prezantuar raportin e plot para jush, andaj me lejoni qe raportin e detajuar ta paraqes në mbledhjen e radhes për gjashtë mujorin e parë.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - E falenderoj komandantin dhe pyeti a ka dikush nga antaret pyetje.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-Koordinator i KKSB-së,për arsye të vonesave me miratimin e Planit të Punës, deri me tani kemi mbajt vetem një mbledhje andaj është dashur patjeter që pas miratimit të Planit të Punës nga Asambleja Komunale të mbajm mbledhje në këtë muaj.

4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqses të komuniteteve etj.)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Me që perfaqsesit ë Kforit nuk janë të pranishëm pyet perfaqsesit e institucioneve tjera a kanë ndonjë çeshtje për ta diskutuar.

N/Tog.Albestrim Rexhepi, FSK- Me që është mbledhja e parë në të cilën marr pjesë, e prezantoj veten dhe vazhdoj, kompanija jon bën bashkpunimin ndermjet FSK-së autoriteteve lokale, Policis dhe Popullates në zonën e pergjegjesisë. Pra jemi të hapur për gjithë antarët e KKSB-së dhe jo vetëm për bashkëpunim, mund ti kembejm të dhënat dhe mjafton kontaktimi nga ana juaj dhe jemi të gatshëm për tju pergjigjë kerkesave për aq sa kemi kapacitete dhe na lejon Ligji. Nuk kemi diçka tjetër ju faleminderit.

Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas - Siguria për komunitetin Egjiptijan nuk kemi vrejte, por shqetsimi jonë është tek punsimi sepse nuk po kemi hapsira të mjaftueshme, pra e kemi problem punsimin. Për Drejtorin e Arsimit kamë pyetje, për transport të fëmijve tu bëhet pagesa nga Komuna në relacione Muzhevinë-Istog, Lubozhdë-Cerrcë-Istog dhe Dubravë-Istog. Informata nga prindërit me që janë të gatshëm prindët ti dergojn fëmit edhe në parashkollor nese organizohet transporti.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Falenderon Ukë Dollcin, dhe shtoj se sa i

perket punësimet janë çeshtje që janë rregulluar me Ligje për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe nese keni verejtje të veçant ju lutem mos hezitoni për ta adresuar, për pyetjen e dytë ftoj drejtorin e DKA-së që të jep një sqarim.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - DKA-ja ka ndermarr masa që të organizoj transportin për të gjith nxënësit që udhetojnë mbi kater (4 km), pa dallim races, gjinis etj. Për të gjitha kërkesat e parashtruara mbi largësin e cekur kemi hapur tender, ndersa për vendbanimet që ju i cekët janë nën dy kilometra nga Shkolla dhe nuk kemi baz Ligjore që të organizojm transport. Kjo është pergjigja e DKA-së.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderoj Drejtorin e DKA-së dhe pyet antarët e KKSB-së a ka diskutime tjera lidhur me këtë pikë. Me që nuk ka diskutime kalojm në pikën e radhes të rendit të ditës.

5. Qent endacak, sulmi ndaj fëmijve dhe personave të ndjeshëm

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - lidhur me këtë tem raportin do ta paraqes përfaqsesi i Drejtoratit për Emergjencia, Mbrojtje dhe Shpëtim, Skender Hasangjekaj.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- Komuna ka kontrat me operatorin ekonomik " Veterina" deri në janar të vitit 2023. Bazuar në Legjislacionin në fuqi për trajtimin e qënve dhe macave endacak, trajtimi bëhet duke i kastruar, vaksinuar mbajtur në karantin dhe pas trajtimit dy javor leshohen në vendin e origjines. Problemi i qenve endacak nuk është vetëm në komunën tonë por është në gjithë Kosovën.

Në vitin 2021 "Veterina" i ka trajtuar 62 qen të trajtuar me vaksin dhe kastrim, ndërsa një qen për arsye të sëmundjes me Eutanazi.

Në vitin 2022 gjer me tani janë trajtuar 80 qen që të gjithë me vaksin dhe kastrim.

Komuna e Prishtinës ka ndermarr disa hapa për trajtimin e qenve në forma të ndryshme duke përfshi edhe mundësin e ngritjes së strehimores, e cila është e kushtueshme për ndertim dhe mirëmbajtje e që i tejkalon mundësit buxhetore të komunës sonë. Jemi në kontakte të vazhdueshme me autoritetin e Komunës së Prishtinës dhe bazuar në këtë përvoj do të duhej zhvilluar bisedime me Komunitat fqinjë si Peja, Klina, ndoshta Skenderaj për ngritje të një strehimore të përbashkët. Personalisht e shof sfidues edhe Ligjin për mbajtjen e qenve shtëpiak, mnyren e shumimit të tyre dhe pergjegjësit e pronarit.

Pra Komuna ka kontrat deri në fund të këtij viti për trajtimin e qënve bazuar në Ligjë, por qytetarët e në veçanti fëmijët dhe të moshuarit janë të rrezikuar nga sulmet e qënve endacak, Në veçanti Shkollat Uçë dhe Rakosh kanë theksuar shqetsimin për raste të sulmeve të fëmijve brenda hapsirave shkolllore-oborrit.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës -Falenderon z. Hasangjekaj për raportin dhe hap debatin për këtë tem.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog - ju informoj se nga data 01.01.2022 deri në këtë moment nuk kemi raste të inicuar në stacionin e Policis por ky problem paraqet shqetsim për qytetar dhe për organet e sigurisë, por kemi pas raste të raportuara dhe i kemi adresuar tek organet kompetente të Kuvendit Komunal.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar - Fenomeni i qenve endacak më shqetson në dy aspekte. Pse shteti jonë nuk e bën zgjidjen e problemit të qenve endacak duke mos dasht ta kritikoj komunën sepse nuk asht e mundur që Komuna ta zgjidhë këtë problem. Të gjithë i shofim në medija kohë pas kohe prezantimet e grupeve të qenve endacak në Prishtin dhe qytete tjera dhe nuk janë pamje të mira qoft edhe nes nuk sulmojn askënd. Por tani më kemi par dhe lexuar se ka pas edhe raste që kan perfundu me fatalitet. Kur kësaj i shtohen traumat e fëmijve, familjarve si dhe kalimtarve të rastit athere problemi është madhor. Ju z. Skender nese merrni pjes në takime të nivelit të lart duhet ti ngrisni këto shqetsime.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- Problemi është krijuar tash e një kohë të gjatë, jo të gjitha komunat janë marr me këtë problem permanent. Kamë informacion se niveli qendror ka hapur procedurat tenderuese për evidentimin e të gjithë qenve shtepiak për të pas mbikqyrje më të mirë mënyren e trajtimit, shumimit dhe perkujdesjes duke marr obligime edhe pronarët e qenve shtepiak. Me legjislacionin në fuqi strehimoret për qen endacak janë me standarde evropiane dhe të kushtueshme, andaj disa strehimore që fillimisht kanë funksionu sikurse ajo e Pejës është dashur të mbyllen për mos plotsimin e kriterëve dhe mënyres së trajtimit të qenve të strehuar.

Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës - falenderon pjesmarrsit në debat duke shpresuar se në një koh optimale do të gjindet zgjidhje e perhershme e këtij problemi. Me që nuk ka diskutues të tjerë kalojm në pikën e gjashtë të rendit t e ditës.

6. Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog - Nga 01.01.2022 dei me 31.05.2022 kemi pas 20 raste të raportuara për dhunë në familje. Në stacionin policor të Istogut të gjithë zyrtarët janë të obliguar që me prioritet të trajtojn çdo informat për dhunë në familje, ndersa në kuader të stacionit kemi dy zyrtar të dy gjinive që janë në kuader të Sektorit të Hetimeve që kanë detyr dhunën në familje. Nga niveli qendror kemi pranuar një projekt të veçant dhe jemi në zbatim të tij sa i perket dhunës në familje. Angazhimi i veçant në këtë projekt ka pas rezultate në uljen e rasteve të dunës në familje, gjatë pës mujorit të vitit 2021 kemi pas 29 raste ndërsa gjatë pës mujorit të vitit 2022 kemi 20 raste do të thot 31% më pak raste. Nese ka pyetje jamë i gatshem për pergjigje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Falenderon kapitenin Gashi, para se ta hap debatin fjalën ja kaloj znj. Servete Haxhijaj.

Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore - Përshendes të pranishmit, Zyrja për barazi gjinore në kuader të planit të punës kemi parapa shumë aktivitete ndër të tjera parandalimin e dhunës si dhe mbrojtja e personave ndaj të cilve ushtrohet dhunë në familje. Aktivitetet tona janë në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive komunale. Më lejoni ti theksoj disa nga aktivitetet që i kemi realizuar gjër më tani. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në bashkëpunim me zyren e personelit kemi vizitu disa institucione, sa janë të mbrojtura të dy gjinit sipas Ligjit punësuar duke përfshi kontratat, pagat, orarin, pushimet. Në bashkëpunim me DKA-në kemi trajtu temën Analiza e kostos financiare për subvencionimin e fëmijve në kopshte për nënat vetëushqyese përfituese të skemave sociale dhe jemi marr veshë që nënat vetëushqyese të jenë të liruara nga pagesat.

~~Me Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadaster kemi mbajt takimin për informimin e të gjitha grave për mundësit Ligjore për rregjistrimin e pronave në emer të të dy gjinive, kështu që brenda këtij viti janë regjistruar 90 rastetë regjistrimit të pronës në emer të të dy gjinive. Në bashkëpunim me OJQ " Vizioni 02" për ditën nderkombtare të komunitetit egjiptian në Ballkan kemi mbajt tryez dy ditore me temen të drejtat e njeriut dhe të pakicave, ku kemi trajtu edhe çështje të racizmit etj. Poashtu kemi mbajt takim me organizaten Medika me temen Desigmatizimi dhe çasja senzitive ndaj të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës 98-99 në Kosovë. Kemi konstatu se në komunën tonë deri me tani nuk ka asnjë rastë të paraqitur të dhunës seksuale. Kemi mbajtur edhe takime tjera dhe vlen të theksohet se bashkëpunim të mirë kemi me Policinë dhe Gjykatën, OSBE-në, zyren e punsimitetj me fokus mbrojtjën e viktimave të dhunës familjare.~~

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon znj. Haxhijaj dhe hapë debatin lidhur me dy raportet e paraqitura. Me që nuk ka komente në raportet e paraqitura, konstatoj se bazuar në raportin e Policisë gjëndja është më e mirë se vitin 2021, porë kjo nuk duhet të na kënaq dhe duhet vazhduar sëpunuari për rezultate më të mira në parandalimin e dhunës në familje.

7. Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuarepengohet lëvizja e lirë e qytetarvenë veçanti personat me nevoja të veçanta

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Për ta paraqitur një rapor lidhur me këtë temë ftoj Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Abedin Kabashi.

Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike- përshendet gjithë të pranishmit, lidhur me temën, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, gjegjësisht me Kap. Enver Gashi kemi bër evidentimin e parregullsive në veçanti parkimin e trotuareve dhe jemi zotuar që të ndikojm në vetëdijesimin e ngasësve të automjeteve duke përfshirë edhe shqiptimin e tiketave për parkim në trotuare duke pënguar lëvizjen e lirë.

Lidhur me pjerrinat, bashkë me zyrtaren e HENDIKOS-it dhe zyrtarin për komunikacion në rrugët lokale dhe qendrat urbane dhe kemi konstatu vëndet ku pjerrinat janë të domosdoshme. Ne si Drejtorat kemi ndermarrë masat në planifikimin buxhetor me qëllim që ky projekt për pjerrina të realizohet në vitin 2023 e që do të kap vlerën rreth 10.000€. Kjo do ishte në pika të shkurta, ju falemnderit, jami i gatëshëm për pyetje.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog - jemi duke zbatuar Planin Operativ trotuaret e lira. Një ekip policor me biçikleta është në patrollim për zbatimin e këtij Plani duke ndermarr masa preventive dhe ndeshkimin e kundervajtësve të ndryshëm. Gjatë pësmujorit të parë të këtij viti janë shqiptuar gjithsejt 2627 tiketa për kundervajtje të ndryshme, prej të cilave 161 tiketa vetëm për parkime ilegale.

~~Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak- kamë një koment lidhur me statistikën e paraqitura nga komandanti, duke ardhur në këtë takim në afersi të qendres tregtare "Beni" trotuaret janë perplot me kerre, kështu që këto tiketa nuk kanë efekte të mëdha. Shtrohet pyetja a duhet angazhuar numer më të madh të policve apo çfar duhet bër.~~

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog - Falenderoj z. Hotovic, sigurisht që shqetsimi yt qendron dhe do të angazhohemi më shumë për të zgjidh kete problem.

Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb- Pershendet të pranishmit desha të ngris çeshtjen e parkimit të automjeteve në varrezat në afersi të Komunës, ka edhe shasija të kerreve dhe nuk është e hijshme të shihen kerret ngat permendoreve në varreza.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- në afersi të objekteve është bër rregullimi i rruges dhe i parkingjeve të dy objekteve me çrast është bër edhe lidhja me pjesen tjetër të rrugës e cila është ende e pa kryer. Mund të ndodh që ngasës të automjeteve i parkojn kerret . do të perkujdesemi me drejtorit perkatse për zgjidhjen e këtij problemi.

Më lejon që më këtë rast ta bëj një pyetje për drejtorin e Sherbimeve Publike, në planifikimin për vitin 2023 i keni parapa vetëm pjerrinat apo edhe rregullimet e trotuareve për persona të verber etj. Drejtorati mund ta konsulltojn komunën e prishtinës rreth procedurave të planifikimit dhe tenderimit dhe të bëhet një zgjidhje e njëhershme edhe për komunitetin e të verberve.

Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas - Shqetsim paraqesin mungesa e shenjave të komunikacionit, vëndkalimeve (zebra) vija e bardhë në mes të rruges etj.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - sa ju perket rrugve regjionale është kompetenc e nivelit qendror, ndersa për rruget lokale Drejtori i Sherbimeve publike mund tna jep një informat.

Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike- Vitin e kaluar e kemi shpall tenderin për sinjalizim vertikal dhe horizontal. Me që ka pas ankesa nga operatori tjetër, landa nuk asht kry në munges të funksionalitetit të OSHP-së dhe për këtë arsye ka vonesa. OSHP-ja është funksionalizua dhe besoj se së shpejti do të kryhet çeshtja e tenderit dhe do të fillojm me sinjalizim.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon Drejtorin Kabashi me qe nuk ka ma debatues kalojmi në pikën e tetë të rendit të ditës dhe ftoj Blendineta Shatrin ta bëj një raport lidhur me temen.

8. Monitorimi i funksionimit të këshillave në të gjitha Shkollat

Blendinela Shatri, EVSB- Raporti i paraqitur nga Blendineta Shatri i bashkangjitet dhe është pjes perbërse e këtij prosesverbali. Nr. 1 RAPORT, MONITORIM I FUNKSIONIMIT TË KËSHILLAVE NË TË GJITHA SHKOLLAT (faqe 1-9)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Falenderoj Blendineten për raport përmbajtsor. Rekomandimet e juaja do ti ken parasysh institucionet përkatse. Hapi debatin lidhur me këtë tem.

Blendor Isufaj, KVRL- sa i perket kësaj teme nga shkollat kemi kerkesa per shtimin e patrollimit të Policisë në afersi të shkoles Veriq-Serbobran dhe Gurakoc me që vozitja e shpejt, paraqet rrezik për nzenës.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog - Falenderoj Blendor Isufaj, do ta kemi parasysh, kërkesën tuaj.

Zenun Bujupaj, perfaqshues i komunitetit Shqipëtar - kamë punuar kohë të gjatë në Arsim, raporti është i detajuar, porë këshilli Drejtues nuk ka për detyr vetëm identifikimin e problemeve por do të duhej të jenë kreativ me ide për zgjidhje të problemeve. Problemi kryesor në Arsim është cilsija, andaj në këtë raport nuk ndegjova ndonjë ide për ngritjen e cilësis në Arsim. Poashtu për mendimin tim mangësi është edhe konstatimi i nivelit të përgatitjes së mësimitdhënësve dhe qasja e mësimitdhënësve ndaj nxënësve. Obligim moral i mësimitdhënësve është në momentin kur del para nxënësve të jep çdo gjë nga vetja që cilsia e mësimitdhënësve dhe mësimitnxënësve të jet në nivel. Konstatim i përgjithshëm është se cilsija e Arsimit në Kosovë nuk është e kënaqshme. Çeshtja tjetër është siguria, kur nxënësit hyjnë në oborrin e Shkollës dhe objektet shkollore në përgjithësi duhet të ken siguri absolute, andaj shoqëria nuk duhet të kursehet për arritjen e këtij standardi.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- qellimi i komisionit ka qen verifikimi i këshillave a janë të themeluara bazuar në Legjislacion dhe ngritja e bashkëpunimit me Këshillat e Shkollës. Ky komision por as KKSJ-ja nuk e ka në

mandat vlersimin e nivelit profesional të mësimdhënësve sepse atë mandat e ka Inspektorati i Arsimit. Nga Raporti keni pas mundsi të vrejini se ka konflikte interesit në disa Shkolla ku kryetar të Këshillit të Prindve është mësimdhënës po në atë shkollë. Sipas stafit menaxherial të Shkollave gjendja me COVID-19 i ka imponuar taskforcat e që janë bër disa zgjidje adhoc që në të ardhmen do të permirsohen. Perfaqsesi i DKA-së ka parashtruar edhe pyetjen nga vlersuesit e cilësis në Shkollë a i prënoni Planet e Punës dhe a e bëni vlersimin. Pergjigja ka qën po i prënojm dhe i vlersojm, andaj ju mbetet zyrtarve të DKA-së dhe Inspektorve që ta bëjn vlersimin e detajuar. KKSB-ja ka të drejt tju bëj ftes këtyre zyrtarve për paraqitjen e një raporti të tillë vetëm për këtë tem.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Besoj se sugjerimet e dhëna në këtë raport do ti marrin të si DKA-ja Komuna dhe institucionet e sigurisë me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit nderinstitucional dhe permirsimin e sigurisë dhe cilësis në Arsim. Me që nuk ka tjer debatues kalojm në pikën e 9 të rëndit të ditës.

9. Problemet që ndikojn në siguri, në zonat urbane të minoriteteve

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Ftoj z. Rasim Mahmutoviq, shefi ZLK-së për paraqitjen e një raporti.

Rasim Mahmutoviq, shefi ZLK-së- I nderuari kryesues i Komitetit, komandant i Policis të nderuar të pranishëm. Sa i perket siguris dhe kontakteve me komunitetet, gjegjësishtë përfaqses të komuniteteve nëper vëndbanime të caktuara mund të konstatojm se siguria e komuniteteve në komunën tonë është në nivel të lart. Gjithsesi ka hapsira për permirsime. Ngjarjet e fundit kanë ndikuar në shqetsimet e komuniteteve si ato:

-Viedhjet në shtepit e pronarve të shtepive ku pronarët nuk janë aty, por ka edhe raste të tentim viedhjeve ku pronaret kanë qën prezent, si psh. Dobrush, Banjë, Lubovë dhe vende tjera

- shqetsim për qytetar janë edhe prerjet ilegale të pyjeve sidomos në rajonin e Tuqepit

- ngasja e automjeteve me shpejtësi të madhe nëper rrukë lokale ku Policia është më pak prezente si rruga Dobrush-Banjë dhe rruga Tuqep-Zallq.

Si komitet dhe komunë do të duhej të sigurohen mjetet për projekte të cilat ndikojn në siguri. Për ti evituar viedhjet perpos prezences së Policis do të duhej siguruar mjete financiare për vezhgim me kamera dhe sisteme alarmi. Si shembull mund ta marrim Osojanin dhe Lubozhdën ku janë vendosur kamerat e vezhgimit dhe niveli i sigurisë është rritur dukshëm. Andaj do të ishte mirë që kamera të tilla të vendosim në rrugët gjegjësisht lokacionet ku viedhjet kanë intenzitet të theksuar si në Banjë etj. Për ta parandaluar prerjen ilegale të pyjeve, komuna do të duhej ta punsoj një pylltar në vend të pylltarit i cilit i ka skadu kontrata. Vendosja e shënjave horizontale të komunikacionit gjegjësishtë pëngesave për ti parandaluar ngasësit e automjeteve të pandergjegjëshëm dhe atë në rrugën Dobrush Banjë dhe në afersi të Shkollës në Serbobran. Sigurimi i mjeteve për ndriçim publik në pjesën nga pompa në Dobrush-Kashicë dhe në afersi të Serbobranit.

Kto janë disa nga çeshtjet që ZLK-ja i ka evidentuar si probleme gjegjësisht projekte të cilat do të ndikojn në sigurin e komuniteteve.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - e falenderon z. Mahmutovic dhe hapë debatin.

Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse- pershendet të pranishmit dhe deshiroj të nderlidhem në raportin e rasimit ku theksoj viedhjen në Kishën në Osojanë ku janë krijuar dëme materiale dhe ende nuk është zbuluar. Kjo ka ndodh në mandatin e priftit të kaluar edhe pse unë jetoj në qender të Istogut dhe siguria ime është në nivel. Por raste të tilla duhen të gjykohen dhe Policia të ndermerr masa në parandalimin dhe në zbardhjen e këtyre rasteve.

Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb- pershendet të pranishmit dhe falenderon Rasimin për raportin në emer të të gjitha komuniteteve. Si perfaqësuese e komunitetit Serb kamë disa propozime. Pastrimi i hapsirës në kishën ortodokse në Gurakoc, varrezat dhe dëmtimi i permendoreve në vorrezat e komunitetit serb në pergjithësi, prerja ilegale e pyjeve në Osojan Tuqep etj. Rrugët ku jetojn komuniteti serb nuk janë të ndertuara-mirëmbajtura ndersa të gjitha rrugët që dergojn tek të gjitha komunitetet tjera janë të rregulluara. Shtyllat elektrike në Osojanë janë të dëmtuara dhe askush nuk ndermerr masa, kemi rast që shtylla është vëndos në osojan por rrjeti ende nuk është bartur në shtyllën e re. Kanali i ujitjes në Dragolevc nuk pastrohet dhe na shkakton probleme me vershime. Vëndosja e pëngesave në rrugë në afersi të Shkollës në Osojanë për shkak të sigurisë në nxënësve. Në fsh. Bellopoj nuk kanë ujë. Kerkojmë që të rinovohet bazeni në Qendrën Rinore në Osojan. Komuniteti serb ka shumë probleme me uzurpimin e pronave, punsimin viedhjet e pyjeve, ju faleminderit.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - e falenderon Svetllanën si dhe prezantimet edhe të rasimit dhe Nebojsa kryesisht janë projekte të cilat ndikojn në mirqenjen e komuniteteve, andaj ju ftoj që ti adresoni nëpër Drejtorit përkatse të cilat i mbulojn këto fusha dhe si administrat do ti trajtojm me përkushtim. Sa i [perket vëndosjes së kamerave që i ngriti Rasimi më lejoni të theksoj se në Osojanë janë të vëndosura por kemi raste kur përsona të pandergjegjëshëm i lëvizin gjegjësisht i keqëdrejtojn dhe efekti i tyre humbet sepse nuk rregjstron udhët por fushat, . Këtë e them bazuar në informacionin që kamë. Sa i perket punësimit të pylltarit ju informoj se Ligji i ri për zyrtar publik nuk lejon më punsim me kontrat mbi veper por duhet shkuar në form ligjoreku janë vende të perhershme të punës. Kërkesën që e kemi derguar në autoriteti qendror pikrishtë për këtë çeshtje kemi marr pergjigje negative, por serish jemi duke hulumtuar mundësi alternative. Sa i perket pëngesave në rrugë ftoj Drejtorin Abedin Kabashi për një pergjigje.

Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike- sikurse e theksova edhe gjatë raportimit tim, procedurat me tenderin nuk janë mbaruar ende andaj të gjitha kërkesat do i shqyrtojm në momentin që kemi kontrat me operator ekonomik. Si ide e drejtoratit është që pëngesat në afersi të shkollave mos të jenë këto të

gjertanishmet por ti bëjm me asfaltë më të nalta dhe më të gjëra për arsye të qendrueshmëris së tyre.

Kap. Enver Gashi Komandant i St. Policis Istog - sa i perket kësaj teme dhe nderlidhur me sigurinë në vendbanime ku jetojn komunitet pakic kamë lëshu një urdhër ekzekutiv për ngritjen e prezences së Policëve dhe vigjilencës në gjitha vendbanimet me komunitete pakicë. Kemi pas takime me përfaqësues dhe tani më niveli i siguris nga takimet e fundit ndjeshëm janë rritë. Qendrimi i Stacionit të Policisë është i qart dhe ka kerkuar zgjerimin e rrjetit të vezhgimit me kamera të sigurisë. Sistemi i vezhgimit me kamera në Osojanë dhe Lubozhdë është aset jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe ka ndiku dukshëm në parandalimin dhe në zbulimin e rastëve në këto vendbanime. Lidhur me sistemin e Kamerave kemi bër disa herë kërkesa ndersa e Fundit është e datës 07.prillë drejtuar Kryetarit Ilir Ferati për transferimin e sistemit në stacionin Policor të Istogut.

Sa i perket rastit në osojan, përmes Vesna Malinkovic popi e ka njoftu policinë e cila ka reaguar me shpejtësi dhe është konstatuar se nuk ka pas nderhyrje nuk ka pas viedhje, megjithatë rasti është ende në hetime. Kur ka ndodhë rasti në Kishë kamerat e siguris nuk kanë funksionuar dhe nuk kemi pas mundsi të vrejme levizjet. Perfundimisht ky rast është duke u hetuar me intenzitet të shtuar.

Zeqir Mehmetaj, Radio“Fontana“ - Pershendetje për të gjithë, nuk desha të inkuadrohem por paraqitjet e problematikes së fundit, më detyruan ta jap një këndvështrim timin. Të gjithë ne qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojm se gjërat kanë ndryshu për këto 23 vite, deshtem dhe s`deshtem ne duhet ta pranojm njëni tjetrin si bashkudhëtar dhe partner, e mos ta konsiderojm njëni tjetrin si kundërshtar. Këta zotrit nga Osojani dhe vendet ku jetojn pakicat në këtë rast po kanë dëshir me i pas duart në të dy pushtetet edhe në Kosovë edhe në Beograd. Megjithse nuk ka ndonjë të keqe si parim, por fakti të tentosh të nxierrish gjithçka nga pushteti i Kosovës dhe të mëndosh me Gjuhën e Beogradit është Problem. Çfar desha të them me këtë. Këtu e kemi drejtorin e DKA-së, aj e dinë si funksionon Arsimi në Osojan, Shendetsija në Osojan etj. Pershembull unë i kam furnizu me material Shkollor Shkollat e Istogut, në Osojan kurr skam mujt ta dergoj një Ditar Shkolle edhe pse janë në gjuhen Serbe. Kamë tentu edhe me institucione tjera të ndermjetsojn por ska pas sukses. Me KFOR-in Italian kam shku në Osojan për dhurimin e një donacioni por nuk kanë leju të bëj gjirime gjatë pranimit dorzimit. Kjo do të thot se donacionet i pranojm por nuk duhet të dihen faktet se komuniteti po ndihmohet nga partner të pushtetit lokal. Pra duhet ta kuptojm të gjithë se në Kosovë ka ndryshu gjithëçka pas luftës mizore që është bër vitet 98-99, duhet të mësohemi të bashkudhëtojm. Edhe unë duhet ta niej vetën të lirë të shkoj në Osojan sikurse aj e ndien veten të lirë të vij në Istog. Pse mu smë lejohet të gjiroj në Osojan, kerkoj asistenc nga Policia e marr pergjigjen shko vetë. Në anën tjetër kërkojn shtylla, kamera etj etj, për siguri. Kerkoj falje se ndoshta isha i zgjeruar dhe ju mora kohë por mendimi imë është se duhet të jemi më tolerant që të dy palet dhe njëni tjetrin ta pranojm si partner dhe në të ardhmën të bashkudhëtojm.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Me që nuk ka tjer anëtarë të lajmruar për diskutim, kalojm në pikën e dhjet tëndit të ditës.

10. Të ndryshme

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Pasi që nuk ka të lajmruar për fjalë, konstatoj se mbledhja e datës 29.06.2022 me kaq perfundon, faleminderit për pjesmarrje dhe për angazhimin tuaj dhe shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja perfundoj:

17.40



REPUBLIKA E KOSOVËS
ISTOGUT
Republika Kosovo
Republic of Kosova



KOMUNA E
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:2	RAPORT, MONITORIM I FUNKSIONIMIT TË KËSHILLAVE NË TË GJITHA SHKOLLAT
Tipi i takimev:	KOMISIONI I KKSBB-SË, ME KËSHILLAT E SHKOLLËS
Data e mbajtjes:	30.05.2022-07.06.2022
Vendi i takimit:	Shkolla
Mbledhjen e kryesoi:	
Procesmbajtës:	Blendineta Shatri, EVSB Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none">1. Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së2. Kap.Enver Gashi, Stacionit Policor;3. Naim Behlulaj, Drejtorati për Arsim;4. Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;5. Blendineta Shatri, EVSB; <p>PS. Antarët e KKSBB-së Kapiteni Enver Gashi dhe Drejtori Naim Behlulaj për arsye të angazhimeve të tyre si antar të komisionit i kan deleguar zyrtarët; Zaim Hysenaj nga Policia dhe Naim Sadriaj nga DKA</p> <p>Mungonë: Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;</p>

1.0 TEMA E DISKUTIMIT

1.1 THEMELIMI I KËSHILLAVE TË SHKOLLËS DHE FUNKSIONIMI I TYRE

Drejtoria e Arsimit ka perpiluar orarin e vizitave në shkolla dhe i ka njoftuar të gjithë Drejtoret e Shkollave me orar si dhe ka kerkuar që në takim përpos Drejtorit dhe zavëndës drejtorit të jenë prezent edhe Kryetari/e e Këshillit të Shkollës, Kryetari/e e Këshillit të Prindërve, Kryetari/e Këshillit të nxënësve dhe Koordinatorit/e i cilësis. Takimet janë mbajtur nga data 30.05-07.06.2022.

Në vazhdim para jush do e bëj një rezime të vlersimeve pa i perseritur çeshtjet që janë diskutu nëpër Shkolla e që janë të përbashkëta.

Në çdo Shkollë Drejtori-sha ka bër hapjen e takimit dhe ju ka dëshiruar mirëseardhje anëtarve të komisionit nga KKSB-ja dhe njëheri kanë theksuar se një iniciativ e tillë është e mirëseardhur dhe shpresojn se do ndikoj në ngritjen e bashkëpunimit të shkollave edhe me institucionet tjera përpos DKA-së. Nga këto takime presim që të kemi rezultate pozitive të dyanshme.

Fillimisht Drejtoret-sha i kanë prezantuar të pranishmit-Kryetarët e këshillave dhe kanë dhan sqarime për mungesat.

Pas Drejtorve prezantimin e komisionit të KKSB-së e ka bër Koordinatorit i KKSB-së, z. Skender Hasangjekaj i cili i ka falenderuar Drejtoret për bashkëpunim dhe ka bër prezantimin e anëtarve dhe arsyen e mungesës së perfaqsesit të këshillit të prindërve dhe në pika të shkurtra të pranishmit i informoj për KKSB-në (bazën Ligjore, mandatin, Planin e Punes, me theks tek siguria dhe ngritja e bashkëpunimit Shkollë-Polici-KKSB si dhe mundsit që ka KKSB-ja për adresimin e sfidave-problemeve të shkollave qoft në nivel lokal apo qendror.

Këshillat nëpër Shkolla janë si në vijim:

GJIMNAZI "HAXHI ZEKA" 30.05.2022-ISTOG

1. Skender Berisha, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Skender Berisha, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Adea Gerguri, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Lindita Kalijani, Koordinatore e cilësisë

SHMLP "MIT`HAT FRASHËRI" 31.05.2022-GURRAKOC

1. Vintor Zeqiraj, Kryetar i Këshillit të shkollës,
2. Vintor Zeqiraj, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Edonis Gorçaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Ismet Ibrahimaj, Koordinatore e cilsisë

SHFMU "BAJRAM CURRI" 30.05.2022-ISTOG

1. Betim Alushaj, Kryetar i Këshillit të Shkollës, (ka dhan dorheqje)
2. Arben Rugova, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Ulpjana Nimanaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Agron Zeqiraj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "MARTIN CAMAJ" 31.05.2022-GURRAKOC

1. Robert Gegaj, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Faik Shatri, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Gjeneta Ramaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Valentina Gjocaj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "HYSNI ZAJMI" 02.06.2022-VRELLË

1. Vlora Vuthaj, Kryetare e Këshillit të Shkollës,
2. Vlora Vuthaj, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Bleonit Mavraj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Jahir Dreshaj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "ZYMER ZEKA" 02.06.2022-KALIQAN

1. Xhemajl Zogaj, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Xhemajl Zogaj, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Endrim Zogaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Florim Lipaj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "TREPÇA" 03.06.2022-BANJË

1. Skender Loxha, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Bashkim Kaliqanaj, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Argusjana Osmanaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Arton Binakaj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "FAN S. NOLI" 03.06.2022-LLUKAC

1. Elona Blakaj, Kryetare e Këshillit të Shkollës,
2. Azem Llumnica, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Florentina Shabanaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Xhyle Sadikaj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "AVNI RRUSTEMI" 06.06.2022-ZALLQ

1. Januz Ahmetaj, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Jeton Mehmetaj, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Urim Osmanaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Florentina Shoshi, Koordinator i cilsisë

SHFMU "ISMAIL QEMALI" 06.06.2022-SARADRAN

1. Bekim Shoshi, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Malush Qeta, Kryetar i Këshillit të prindërve
3. Shqiponjë Osmanaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Vintor Zeqiraj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "NDRE MJEDA" 07.06.2022-RAKOSH

1. Gani Salihaj, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Vlora Sylaj, Kryetare e Këshillit të prindërve
3. Florenta Fekaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Gani Arifaj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "TRE DËSHMORËT E SHKOLLËS SHQIPE" 07.06.2022-UCË

1. Nexhmedin Hajrizaj, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Astrit Ramaj, Kryetare e Këshillit të prindërve
3. Anisa Behluli, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Shaban Sahitaj, Koordinator i cilsisë

SHFMU "MEHMET AKIF" 07.06.2022-SHUSHICË

1. Samire Ajzeraj, Kryetar i Këshillit të Shkollës,
2. Muharrem Metaj, Kryetare e Këshillit të prindërve
3. Zanfina Sahitaj, Kryetare e Këshillit të nxënësve,
4. Sidorela Hetemaj, Koordinator i cilsisë

Stafi menaxhues i shkollave dhe Kryetarve të këshillave të shkollave në veçanti kanë falenderuar policin e Kosovës-Stacionin Istog për bashkëpunimin e mirë, por që Shkollat e mesme si dhe ato filloret në Istog, Vrellë, Kaliqan, Banjë, Saradran, Rakosh dhe Gurakoc kanë kërkuar prezenc të Policisë mbas mbarimit të mësimit para dite dhe fillimit të mësimit pas dite për shkak të siguris në komunikacion dhe numrit të madhë të nxënësve.

- Në Llukavc paraqitet problemi në komunikacion me që ka të mitur që drejtojn automjetet dhe atë me shpejtsi të madhe, andaj prezenca e Policis në mbarim të orve mësimore do të ishte e mirëseardhur.
- Hyrjet e prindve në shkollë në çdo kohë, pengon procesin mësimor
- Në Istog dhe në Banjë, rasti i nderhyrjes së prindit mes konfliktit të nxënësve, kemi lajmru Policin dhe rasti është procesu në institucione
- Ka konflikte verbale të vogla mes nxënësve
- Hyrja me automjete në brendi-oborr të shkollës paraqet problem
- Ka raste që konflikte verbale apo konflikte tjera mes nxënësve të ndodhin jashtë perimetrit të shkollës, e që stafi drejtues nuk ka mundsi të ndermerr masa
- Sfid paraqet pjesmarrja e vogel e prindve në mbledhjet e këshillave të prindve
- Hapja e llogarive të rrejshme në rrjetet sociale po krijon konflikte dhe po barten mes nxënësve në Shkollë
- Përdorimi i pijeve energjike, pra shitja nën moshen e lejuar
- Përdorimi i cigares, shitja nën moshen e lejuar dhe me copë
- Përdorimi i telefonave në disa shkolla.

2.0 PROBLEME TË VEÇANTA SIPAS SHKOLLAVE:

2.1 GJIMNAZI “HAXHI ZEKA”

Perdorimi i pijeve alkoolike në afersi të Shkolles

Këshilli i nxënësve: synim i veçant ka qen formimi i klubeve të ndryshme si aj i ambientit i siguris dhe klube tjera dhe funksionimi i tyre duke paraqitur edhe kërkesat dhe problemet e tyre përmes Këshillit të nxënësve në Këshillin drejtues.

2.2 SHMLP “MIT`HAT FRASHËRI”

Këshilli i prindërve mbajmi takime të rregullta dhe gjithë i pergjigjen ftesës. Ne ju kemi drejtu KSH-së me kerkesën për problemin e ngritjes së çmimit të biletës së transportit si dhe zgjidhjen e problemit të linjes së transportit për nxënësit e shkollës në relacionin Kaliqan-Gurakoc dhe Uçë-Gurakoc, me që nxënësit detyrohen dy her të paguajn dhe atë për transport deri në Istog dhe nga Istogu deri në Gurakoc. Me këtë rast ngarkohet xhepi i prindërve, rrezikohet siguria e nxënësve, ka vonesa në shkollë dhe mungesa të pa arsyeshme për këtë shkak. Për ne si prind është shumë e rëndësishme që të zgjidhet vija vajtje ardhje Kaliqan-Gurakoc dhe Uçë-Gurakoc.

Udhëheqsia e shkollës me këtë rast theksoj se si pasoj e këtij problemi nga perfundimi i klases së 9-të pothuajse çdo vit rreth 100 nxënës na ikin në Pejë. Ne si shkollë jemi të gatshëm edhe në participim me mjete për zgjidhjen e këtij problemi-transporti.

Poashtu siguria në shkollë ka rrezikshmeri shkak i mungesës së rrethojës të cilen nuk kemi mundsi ta ndertojmi për shkaqe të problemeve pronsore, andaj kerkojmi një zgjidhje nga institucionet komunale.

Vlen të theksohet se Këshilli i nxënësve në takime pos tjerash ka debatuar temat përdorimi i duhanit; ngacmimet seksuale; bullizmi etj, kemi pës nxënës me nevoja të veçanta dhe kemi ndermarr masa që nxënësit të perkujdesën për ta.

2.3 SHFMU “BAJRAM CURRI”

- Kemi ndermarr masa dicitplnore dhe kemi transferu tre nxënës në Vrellë, Rakosh dhe Shushicë si dhe largim tre ditore nga Shkolla
- Problem i vazhdueshem me dy nxënës të komunitetit Egjiptian, prindi Visar Shpatollaj, nxënësit në kl. 3-të dhe 6-të të cilët bëjnë presion tek mësimdhënsit se komunitetet pakic i mbron ligji.

2.4 SHFMU “MARTIN CAMAJ”

Frekuentimi i nxënësve nga Shkolla Teknike

Hyrja me automjete në oborrin e Shkolles

Numri i madhë i nxënësve në kombi busët privat

Kerkes e Këshillit të prindërve, Inspekcioni të ndermerr masat Ligjore ndaj operatorve ekonomik që shkelin ligjin për shitje të alkoholit dhe duhanit

Mungesa e furnizimit me ushqim dhe gjesende tjera brenda rrethojës paraqet problem të madh për sigurin e nxënësve në komunikacion, andaj kerkojm shqyrtimin e mundsive për lejim të një operatori brenda rrethojës.

Nese kjo nuk është e mundur atëher të vendosen shenja plotsues të komunikacionit.

2.5 SHFMU “HYSNI ZAJMI”

- Çeshtja e parkingut për mësimdhënës
- Transportuesit brenda oborrit të shkolles, të rregullohet parkingu pas objektit të shkollës me ndihmen e DKA-DSHP-së
- 2 kombibus transportues, të analizohet participimi për transport të nxënësve për arsye të ngritjes së çmimeve dhe gjendjes ekonomike të prindërve

2.6 SHFMU “TREPÇA”

- Ka ndodhë një sulm nga prindi i nxënësit, rasti është lajmru në Polici dhe është procesuar tutje. Bëjm kontrolla të kohëpaskohshme dhe para 10 diësh kemi gjet një thikë tek një nxënës, shqetsimi i jonë është me që kemi informata se nxënësit i mshefin tek një lokal para objektit shkollor thika-boksa hekuri.
- Shitja e cigareve me copë
- Prind të papergjegjshëm vinë dhe hyjn pa leje në shkollë, krijojn skandale dhe na qesin në pozitë të keqe

Kryetar i Këshillit të prindve, Shqetsimi kryesor për ne është siguria në komunikacion në afersi të Shkollës me që në vitin 2021 kemi pas tri aksidente me lendime trupore të nxënësve

Kemi bër peticion me rreth 100 nënshkrime për DSHP dhe zyren e kryetarit 01-016/0021755.

Problemet me largimin e mësimdhënësve sipas disa të dhënave 2-3 raste, zavendsimi i tyre po merr koh të gjatë andaj duhet gjetur zgjidhje me avansimin e bazës Ligjore.

2.7 SHFMU “FAN S. NOLI”

- Në shkollën e komunitetit Boshnjak zavëndsimi i orve të TIK-ut na ka paraqit problem, jemi në fazën perfundimtare para daljes në shkollën e re me çrast besojm se do të tejkalohen edhe problemet me mungesat e kabineteve. Me qe jemi shkollë jashta qendrave urbane nuk kemi probleme.
- Koordinatorja e cilësis, kemi nevoj për disa kushte teknike për zbatimin e procesit mësimor

2.8 SHFMU “NDRE MJEDA”

- Rregullimi i shtratit të lumit në afersi të shkollës-siguria e nxënësve
- Qent endacak në oborrin e shkollës, ka raste kur janë agresiv

2.9 SHFMU “TRE DËSHMORËT E SHKOLLËS SHQIPE”

Dalja në shkoll të re duhet rrethoja e objektit dhe kamerat të vëndosen në objekt.

Qent endacak në oborrin e Shkolles po sulmojn nxënësit

2.10 SHFMU “MEHMET AKIF”

Organizimi i garave të shumta po paraqet problem për ne për organizimin e transportit dhe shujtes për garues-nxënës

Grupet e krijuara permes lidhjeve telefonike-rrjete sociale gjatë pandemis i kemi aktiv ende andaj kontaktojm me prindë

3.0 REKOMANDIMET PËR SHKOLLA:

Antarët e Komisionit, Këshilli Drejtues i Shkollës nuk është i themeluar në pajtim të plot me Ligjin 04/L-032 Neni 17, me që në nderkoh pas zgjedhjeve të vitit 2019 janë bërë plotsime në disa shkolla. Këshillit Drejtues dhe udhëheqsis së Shkollave i është sugjeruar që në shtator të përmbahen Ligjit me rastin e zgjedhjeve të këshillave.

Këshillat të hartojnë planet e punës dhe të përcaktohet koha e realizimit të tyre

Të identifikohen mungesat e mësimdhënësve, sepse një mungesë e mësimdhënësve krijon dhjetra mungesa të nxënësve.

Të ndermerren masa për ngritjen e cilësisë dhe sigurisë në shkolla.

Planet detyimore të analizohen dhe të vlersohen, nga koordinatorët e cilësisë

Të nxirret vendimi i Shkolles për vendosjen e kamerave, personi përgjegjës për monitorimin e kamerave, mënyra e ruajtjes dhe përdorimit të inçizimeve bazuar në Ligjin 06/L-082 për Mbrojtjen e të dhënave Personale, Kreu 16, vezhgimi me kamera

3.1 REKOMANDIMET PËR KKSBB-NË-KRYETARIN E KOMUNËS:

- Drejtoria për Shërbime Publike gjegjësishtë zyrtari për komunikacion, në bashkëpunim me Policinë dhe Drejtorinë e Shkollës të hartojnë planin për masat e nevojshme (shenjzime-pengesa në rrugë) deri në mbledhjen e radhës së KKSBB-së
- Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me DKA-në të bëjë zgjidhjen e linjave për transport të nxënësve Uçë-Istog-Gurakoc dhe Kaliqan-Istog-Gurakoc
- Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me DKA-në të analizojë dhe të propozojë zgjidhjen për vend parkime për mësimdhënës, sidomos Vrellë
- Drejtoria për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim, në bashkëpunim me operatorin ekonomik për trajtimin e qenve endacak të hartojë një plan të veçantë për trajtim dhe mbikqyrje të rrethës së Shkollave.
- Kryetari i Komunës në bashkëpunim me DKA-MASHT të analizojë mundësinë e dhënjes së lejes për furnizim me ushqim, brenda rrethës së Shkollës, duke i analizuar specifikat e secilës Shkollë në veçanti
- Drejtoria e Arsimit tju rekomandojë të gjitha Shkollave që të përdorin modelin e ShFMU "Ndre Mjeda" për mbajtjen e procesverbaleve, me nënshkrime dhe foto të pjesëmarrësve
- Drejtoria e Inspektionit të bëjë inspektimin më të shpeshtë të kiosqeve dhe lokaleve në afërsi të Shkollave me theks të veçantë shitja e duhanit dhe pijeve alkoholike-energji nën moshën e lejuar
- Asambleja Komunale të analizojë modelin e Gjilanit për ndalimin e pijeve alkoholike në afërsi të Shkollave